

LIRIKA FSHATARESKE NË PËRMBLEDHJEN “BULZAT” TË AZEM SHKRELIT

RURAL LYRICS IN THE COLLECTION "BULZAT" BY AZEM SHKRELI

Adelina XHAFERI

adelina.xhaferi@unite.edu.mk

Abstrakt

Me këtë punim dhe me çdo varg të përzgjedhur brenda tij, duke e përdorur metodën e deduksionit dhe metodën e analizës letrare do të tregohet se si disa nga poezitë lirike të Azem Shkreli kanë bartur në vetvete elemente fshatareske që nga koha e krijimit të tyre. Këto elemente nuk e japin vetëm me kohën në të cilën krijoi poeti në fjalë, por edhe kujtesën popullore të përfshirë në lirikën moderne shqiptare. I dhënë në lirikën fshatareske të përmbledhjes “Bulzat” është i lidhur aq bukur me vetveten e tij sa që në raste të caktuara është e mundur që vetëm me të, të mësohet e të flitet për atë që sot brenda letërsisë quhet kujtesë popullore. Më pak e njohur për këtë lirikë ashtu siç do të tregojë punimi është edhe: norma e vjetër kanunore, fjala e të parit të shtëpisë, shamia e bardhë në kokën e grave shqiptare, (pa)fati i takimeve dashurore në krra, dhënia e besës për një dashuri të madhe dhe mosrealizimi i saj, fati i mbrapshtë i njerëzve përgjatë shekujve, lidhja e malësorëve/fshatarëve me tokën, me livadhin dhe me nderin e shtëpisë, dhimbja për të nesërmen etj., të cilat duke qenë shpërthim i një kohe të trashëguar bëhen pjesë e kësaj lirike edhe te ky autor.

Fjalët kyçe: letërsia, lirika fshatareske, e vjetra, fati

Abstract

With this paper and with each selected verse within it, using the method of deduction and the method of literary analysis, it will be shown how some of Azem Shkreli's lyrical poems have carried within them peasant elements since the time of their creation. These elements not reflect only the time in which the poet in question created, but also the popular memory included in modern Albanian lyrics. Given in the peasant lyrics of the collection "Bulzat" is so beautifully connected to itself that in certain cases it is possible to learn and talk about what is today called popular memory within literature only through it. Less well-known about this lyric, as the paper will show, are: the old canonical norm, the word of the head of the house, the white headscarf on the head of Albanian women, the (un)luck of love meetings in the village, the promise of a great love and its non-realization, the bad luck of people throughout the centuries, the connection of highlanders/peasants with the land, with the meadow and with the honor of the house, the pain for tomorrow, etc., which, being an explosion of an inherited time, become part of this lyric also in this author.

Keywords: literature, rural lyrics, the old, fate

Hyrja

*Po' n'kanu t'maleve tona
E egër vjen dashnija.¹*

Duke pasur parasysh faktin se bota e madhe e letërsisë nuk njeh vetëm me karaktere të ndryshme të personazheve të vendosur në kohë dhe hapësirë të (para)caktuar që tregojnë edhe për lirizmin e fuqishëm të subjekteve lirike, duhet theksuar se brenda tyre dalin elemente të natyrave të shumëllojta, të cilat e tregojnë anën e fuqishme dhe tërheqëse të autorit. Këto lirika

¹ Azem Shkreli, (1967), *Bulzat*, Rilindja, Prishtinë, fq. 30.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v12.i23-24.p2948>

të vëna në pah gjatë shpalosjes së subjekteve lirike shprehin ndjenja të cilat lidhen me përjetimet e përditshme, apo herë të tjera edhe me vetë kujtesën e autorit të bartur ndër vite e të futur më vonë në atë që quhet art i letërsisë (qoftë shqipe apo e huaj) dhe botë e veçantë artistike.

Letërsia shqipe gjatë gjithë rrugëtimit të saj, të lehtë e të vështirë dhe nga një pasqyrim i plotë të cilin arrin që ta japë për kohën e sotme, me morinë e madhe të autorëve të saj ndër shekuj, periudha e vite të njëpasnjëshme, pavarësisht kërkesave dhe nevojave të kohës arriti që të jetë e bollshme. Ajo, duke u mbështetur në përzgjedhjen e autorëve më të zëshëm dhe mbizotërimit të tyre nga periudha në periudhë e nga koha në kohë, brenda vetes ngërtheu jo vetëm autorë të cilët u munduan që në një mënyrë a në një tjetër ta vinin në pah të kaluarën historike me çdo element ndriçues të saj, por edhe vetë autorin, i cili po nga kjo e kaluar e mori elementin më të bukur të përditshmërisë për ta sjellë në atë që quhet kohë moderne. Po të shihet ajo që njihet si poezi bashkëkohore shqipe, del se është njëra ndër më të veçantat në historinë e letrave dhe mendimeve shqipe, jo vetëm për faktin se brenda vetes trajton tematika dhe motive nga më të ndryshmet, por edhe për strukturën e saj të jashtme dhe rrjedhën e natyrshme që fund e krye arrin të depërtojë në botën e lexuesve. Këta të fundit tashmë nuk lexojnë vetëm vargje, fjalët e të cilave në të kaluarën mëtonin të çonin në mbrojtje të vendit dhe në çlirim nga sunduesit e huaj, por edhe vargje të cilat qenien njerëzore e çojnë në pedestal, duke ia vënë mbi gjoks ndjenjën e dashurisë, mallit të pashuar, hidhërimit të pasosur, gëzimit të panumërt, dhimbjes së trashëguar.

Me këtë rast ata nuk njohin vetëm poetë që këndojnë për dashurinë e që herë-herë atë e japin fund e krye larg asaj që quhet tokësore, por edhe vargje të cilat dëshmojnë për një kujtesë dhe për një mënyrë të vjetër jetese për masën populllore. Vetëm në këtë mënyrë duke u mishëruar me këto vargje është e pranueshme ajo që ka thënë me kohë Aristoteli, se: *“Njerëzit, poezinë e lidhin ngushtë me masën e prandaj i quajnë një palë poetë elegjiakë, një palë të tjerë poetë epikë, duke dhënë titullin e poetit jo sipas farës së imitimit, por sipas masës”*.² Ndjenjat e lartpërmendura, të dhëna në përmbledhje të ndryshme poetike e të mishëruara lehtas me jetën dhe ndjesitë/emocionet e lexuesve arritën që për një kohë të shkurtër të bëheshin jo vetëm të zëshme, por edhe pjesë e përditshmërisë në vite të caktuara. Kjo lidhshmëri ashtu siç do të dëshmohet edhe më poshtë me vargjet e përzgjedhura, arriti që të frymojë e të jetojë ashtu siç lidhej koha e kaluar me këtë të sotmen, apo siç lidhej malli me ndjenjën e dashurisë.

Breznia e poetëve të rinj

Në të gjitha këto vite të caktuara krijuan autorë të shumtë, duke dëshmuar në këtë mënyrë se vargu i tyre, pra vargu i një brezi të ri do të agonte i lirshëm kurdo që të dilte në dritë dhe do të dëshmonte se liria njerëzore në mos ndryshe nga “hapësira e tyre krijuese”, së paku në artin individual duhej të ishte e pranishme. Kjo gjë do të ndihej sidomos atëherë kur të synohej prurja e diçkaje të re dhe ruajtja e asaj që është kujtesë ekzistence. Me këtë rast ashtu siç tashmë dihet brenda asaj që zënë kornizat e letërsisë shqipe, *“kjo breznia poetësh i bëri me dije opinionit të lexuesve se një letërsi mund të përparojë e të zhvillojë seriozisht vetëm duke e vënë në funksion secili krijues prirjen dhe aftësinë e tij, intuitën dhe imagjinatën, ndjenjën dhe mendimin etj, sigurisht pa pranuar asnjë lloj nënshtrimi e imponimi të jashtëm”*.³ Me të gjitha këto tipare dhe të veçanta të përmendura në këtë punim shkencor, poezia e periudhës bashkëkohore në letërsinë shqipe do të pasurohej dhe në një mënyrë a në një tjetër do të dëshmonte për një tokë të bekuar e të munduar shqiptare me krijues të denjë, të cilët me dëshirën e pasosur dhe vullnetin e madh do të tregonin se *“zgjerimi i horizontit tematik dhe stilistik,*

² Aristoteli, (2006), Poetika, Çabej, Tiranë, fq. 18.

³ Ahmet Selmani, (1996), Poezia dhe individualiteti, Flaka e vëllazërimit, Shkup, fq. 20.

pasurimi i fondit të shprehjes dhe i tematikës krijuese, trajtimi organik i temës shoqërore dhe intime”⁴ ishin vetëm disa nga karakteristikat ideoartistike për këtë poezi të kohës.

Një punë të tillë dhe me elemente të një ekzistence të përhershme në atë që ngërthejnë krahët e shoqërisë shqiptare bëri edhe poeti i njohur i letërsisë shqipe, Azem Shkreli, vargjet e të cilit, ashtu siç shihet edhe në përmbledhjet e tij poetike, aq sa janë lirika të fuqishme të lagura me shi të vazhdueshëm, po aq janë edhe bulëza të fytyrave të shumta e të mrrolura shqiptare. Si krijues i vargut të lirë e të nevojshëm për një ndryshim mbarëshoqëror dhe si përfaqësues i një lirie letrare, Azem Shkreli arriti që në letërsi ta sillte jo vetëm frymën e re për të cilën kishte nevojë shoqëria e kohës, por për të, ta bënte të afërt e të ditur edhe atë që nuk ishte e përjetuar. I tillë për vargun të cilin e krijoi ai ishte elementi i vjetër i një shoqërie malësore, një shoqërie të theksuar fshatare e cila ndonëse funksiononte në atë që quhej “e sotme”, brenda vetes e bartte atë që ishte kujtesë nga “e djeshmja”. Kjo nuk dilte vetëm në mënyrën se si i këndohej apo se si i shkruhej emocionit më të vjetër të shoqërisë njerëzore, pra emocionit të dashurisë, por edhe për atë se si ky emocion rritej ashtu siç rritej vajza me shami në kokë, apo djali fshatar me zërin e pushkës në një hapësirë shqiptare. Këta të fundit edhe në brendinë e vargjeve të tij jepen të rrethuar gjatë gjithë kohës me mjetet e punës, me zërin e natyrës, me dhembjen e gurit e të tokës, me frikën e baballarëve për nderin e vajzave, apo herë të tjera edhe me vetë normën kanunore të ngulitur rrënjësisht në mendësinë e tyre. I bindur se këto elemente të veçanta dhe simbolika të fuqishme të asaj që quhej shoqëri shqiptare do të mbeteshin dëshmia më e mirë dhe më e drejtë për atë se si kishte rrugëtuar kjo shoqëri dhe në cilat pika ishte munduar që ta lidhte kujtesën, Azem Shkreli vargjet e tij lirike u mundua që t’i thurte me vetë frymën e lartpërmendur.

Fryma e lirikave fshatareske

Poezia “*Rrëfimi i gjyshes*” me vargjet e së cilës u fillua edhe vetë ky punim shkencor, është mjaft e bukur jo vetëm për nga mënyra se si lidhet me simbolikën kryesore të përvojës dhe kujtesës së jetës, apo me një dashuri të përhershme të fshehur e të ruajtur në gji, por edhe për faktin se brenda vetes mbështillet nga një lirizëm sa i thellë, po aq edhe i bukur e i lehtë. Poezia në fjalë me një natyrë të veçantë rrëfimtare moderne, në raste të caktuara duket sikur gjyshen, këtë figurë të pazëvendësueshme të vetë poetit (dhe jo vetëm) e sjellë edhe përballë lexuesit jo vetëm për të treguar se si (nuk) funksiononte emocion i dashurisë në një hapësirë me elemente të theksuara malësore, por edhe për të thënë se poezia si krijim i moçëm artistik do të mbetet gjithmonë e ngërthyer me këtë emocion, pavarësisht asaj se a do të përjetohet ose jo.

Duke iu kthyer në çdo çast asaj se çfarë i kishte rrëfyer gjyshja dhe se si ia kishte treguar të kaluarën e vjetër të shoqërisë shqiptare të kohës, Azem Shkreli, si shkrimtar dhe si përfaqësues i zëshëm i periudhës së letërsisë bashkëkohore shqipe arrin që po atë rrëfim ta nisë me vargjet e dhëna më poshtë në punim, të cilat siç edhe do të shihet, pasi që lidhen me vetë fjalët e vargjeve të fundit, në vetvete e paraqesin “nisjen” dhe “mbarimin” lirik, ashtu siç edhe ndodh me çdo cikël tjetër në jetën e (pa)zakonshme të asaj që quhet shoqëri njerëzore. I bindur që dy subjektet lirike (vasha dhe djali i ri të dashuruar lehtas) më të zëshme që nga koha e vargjeve dhe shkrimeve të bartura nga brezi në brez e nga koha në kohë të vetë letërsisë popullore, do të jenë bartës të vazhdueshëm të asaj që duhej jetuar në atë rreth hapësinor dhe në atë vorbull të mirash e të këqijash shoqërore, Azem Shkreli këtë poezi e fillon duke u mbështetur në të kaluarën, po aq sa mbështetet secili poet në atë të cilën e bartte ndër shekuj vetë historia. Andaj, jo më kot vargjet nismëtare të kësaj poezie rrëfimtare duke u kthyer në atë që soditi e kaluara me tërë natyrën dhe fuqinë e saj tingëllojnë në këtë mënyrë:

Kan’ qenë një vashë e i djalë

⁴ Agim Vinca, (1997), Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe 1945-1980, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, fq. 106.

*E djali n'vashën a' tekë,
Kan' ra të dy në një fjalë
E t'dy n'dashni jan' pjekë.*⁵

Duke u ndërlidhur me vetë funksionimin e shoqërisë së kohës nën normat e njëpasnjëshme kanunore, siç thuhet edhe nga vetë vargjet e kësaj lirike moderne, fati dhe e ardhmja e këtyre dy të rinjve ndonëse rrëfëhet me një theks të mallëngjyer për faktin se dashuria e tyre pavarësisht nevojave vinte e egër dhe me një natyrë të tillë që arrinte të bëhej pjesë e maleve dhe e natyrës së bjeshkëve, shihet se po kjo “*pjekje*” për subjektet e tilla lirike bëhet “*djegje*”. Veprimet e përmendura në këtë pjesë janë dëshmia e vetme se si ndjenja më e vjetër njerëzore vihej përballë elementit fshataresk dhe në kundërshtim të asaj se si duhej të dashurohej në rrethana e hapësira të tilla të kohës. Kjo gjë, pra kapërcimi i veprimit nga “*pjekja*” në “*djegje*”, i thënë e i qëndisur lehtas nga pena e autorit dhe nën ndjekje të vazhdueshme të zisë së dy subjekteve lirike të lartpërmendur, ndonëse me vargje të bartura rreth dëshmisë së paharrueshme (vetë gjyshes) se si shqiptarët malësorë vdisnin me kanun në gjji, del si më poshtë:

*Kan' qenë, po, vashë e djalë,
E vasha n' djal'in a' tekë,
Kan' ra të dy n' një fjalë
Po' t'dy n'dashni janë djegë.*⁶

Poezia tjetër e cila brenda vetes e fsheh anën e një ekzistence fshatare në kohën e vjetër, teksa qeniet njerëzore shqiptare ishin të dhëna fund e krye kah ruajtja e nderit të vajzës dhe përshkrimi i bukurisë së saj të jashtme, është poezia “*Bija e fshatit*”. Kjo poezi e dhënë në frymën e katër strofave të veçanta e të thurura lehtas, ashtu siç dilnin edhe vetë krijimet e letërsisë së ashtuquajtur popullore (te të cilat e gjetën mbështetjen tematike dhe gurrën kryesore shumë poetë të letërsisë shqipe), me tërë fuqinë krijuese dhe dhuntinë letrare të Azem Shkrelit si poet bashkëkohor, këtë figurë të pashmangshme të letërsisë si art e jep të dëshirueshme nga të gjithë barinjtë (djemtë e rinj) e fshatit sidomos për faktin që ishte e “paprekur”. Ata të gjithë, të bindur se dashurinë e përhershme të jetës së tyre do ta gjenin në hapësirat më të bukura e më tërheqëse të vetë tokës shqiptare, si në: kroje fshattrash, lëndina përralore, bjeshkë të larta e të paarritshme, fusha të bleruara a livadhe të gjëra, si dhe duke u mbështetur në jetën dhe mënyrën e funksionimit të të parëve të tyre dhe në vetë ëndrrat e qëndisura netëve të ndryshme të jetës, bëjnë që edhe autori “këngën shqiptare” dhe “ëndrrën” e vetme të tyre ta paraqesë në njërin nga poezitë e tij lirike, si dhe ta japë me natyrën e vargjeve të mëposhtme:

*Lugjet bleroshe n'bjeshkë ia ruejnë fëmininë
E mrizet ku hangër drekë,
Si fiera u rrit; tanë barija e dijnë
Se kurrkush s'e ka prekë.*⁷

Kjo poezi në të cilën poeti nuk flرتون me realitetin dhe nuk e “zbukuron” të vërtetën jetësore⁸, ashtu si shumë të tjera, duke pasur parasysh faktin se për disa elemente të vjetra mbështetet në atë që quhet letërsi popullore, nuk mund ta linte anash as frikën të cilën e kishte në vetvete figura e babait të një vajze të bukur e tashmë të rritur. [sic!] Përshkrimi i shtatit të saj të hedhur e të derdhur në natyrën malësore të kohës, e futur në rrugica të takimeve të befasishme e të pëlqyeshme dashurore, rritja dhe kundrimi i bukurive të saj fizike të vëna në pah me kapërcimin e viteve, bëjnë që të lindin e të qëndisen vargjet e mëposhtme në të cilat tashmë i veçantë nuk është vetëm përshkrimi i kësaj bukurie, por edhe figura e babait, simbolit të saj mbrojtës. Ky i fundit, ashtu siç tashmë dihet nga kujtesa popullore e futur dhe e ngërthyer në krahët e letërsisë, qëllim kryesor të jetës e kishte mbrojtjen e vajzës dhe ruajtjen e saj për aq kohë sa ishte në duart

⁵ Azem Shkreli, (1967), Bulzat, Rilindja, Prishtinë, fq. 30.

⁶ Azem Shkreli, (1967), Bulzat, Rilindja, Prishtinë, fq. 31.

⁷ Po aty, fq. 27.

⁸ Agim Vinca, (1997), Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe 1945-1980, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë, fq. 107.

e tij që kur të vinte koha, të dëlirë dhe pa njolla ta dorëzonte në shtëpinë e një njeriu, të cilin do ta bënte mik. Andaj, jo më kot autori këtë frikë babai e shpreh me vargjet e mëposhtme:

Kreni nuk ka, por udhës kah shkon derdh shtatin

E vithet i kanda me i kqyrë;

Miqt kur vijnë te dera e thërrasin t'jatin,

Gjaku i ndërrohet n' f'tyrë.⁹

Për nga natyra e veçantë e thurjes së fjalëve dhe përshkrimi i elementeve të vjetra malësore mbrapa nuk mbetet as poezia **“Korrtarja”**. Poezia e tillë, ashtu siç del që në titull shihet se rrëfimin do ta shtjellojë për një subjekt lirik grua (vajzë), e cila duke u lidhur me simbolet më të veçanta e më të bukura të vetë hapësirës dhe kohës shqiptare, si: drapër, shami e bardhë, djep, ograjë, kallinj, arë, drithëra etj, arrin që ta paraqesë dashurinë më të madhe për jetën e re të lindur (foshnjën) dhe dhënien e jetës (qumështin e gjirit) për aq kohë sa e kishte në krahë. Andaj jo rastësisht pas gjithë përshkrimeve të bukura të cilat kalojnë nga strofa në strofë e nga vargu në varg, autori arrin që poezinë në fjalë ta përfundojë me vargjet e dhëna si më poshtë:

E kur t'ket' nisë buzë are me d'nesë ujet

Foshnja e mitun n'djep,

Drapnin n'arë e lëshon plot shend e turret,

Dashni dhe sisë i jep.¹⁰

Poezia tjetër e Azem Shkrelit e cila ka vlera të mëdha jo vetëm për mënyrën e ndërtimit të saj strukturor dhe kapërcimit të lehtë të fjalëve lirike nga strofa në strofë, por edhe për dialogun e bukur e të veçantë lirik i cili ndërtohet ndërmjet babait dhe të birit është poezia e titulluar **“Malli”**, subjektet lirike të së cilës paraqesin një botë të bukur e të vjetër malësore shqiptare. Babai dhe i biri në këtë poezi me frymë e natyrë bashkëkohore, të vënë në shpirtra të lirë dhe me paraqitje të theksuar lirike, mallin, njërin ndër elementet më të përdorur në krijimtarinë artistike-letrare dhe motivin më të harxhuar lirik, e paraqesin në raport me të djeshmen dhe me simbolikën e vetë fyellit. Ky i fundit duke qenë se në pjesën e përditshmërisë shqiptare, me theks të veçantë të jetesa e barinjve, ishte i pashmangshëm, atëherë nuk mund të mbetej pa u kujtuar edhe në të sotmen (në të sotmen e poetit) me vargjet e mëposhtme të subjektit lirik baba, i cili duke qenë i bindur se vetëm falë melodisë së fyellit do t'i fliste e kaluara, atëherë ishte i gatshëm që ta bënte lutjen më të përzemërt për (ri)takimin me të. Ja se si del lutja e tij:

Rrok at fyell, o bir, e ditët kujtomi

Që n'këto shullaje rritë m'kan' e rreshkë,

-I u lut plakut t'birit malsor në bjeshkë.¹¹

Thirrja dhe lutja e të atit që me melodinë e fyellit i biri t'ia kujtonte të kaluarën dhe në veçanti ditët e përjetimit të tij dashuror, bëjnë që poezia e tillë lirike ta ndërtojë njërin ndër dialogët më të bukur, jo duke u nisur vetëm nga e veçanta që del ndërmjet dy gjeneratave të ndryshme, por edhe nga kureshtja e të birit për këtë mall të përditshëm të babait të tij. Do të thotë, vetë lidhja shpirtërore që kishin dy subjektet e këtilla lirike bënte që edhe në jetën e tyre të përditshme ta nxirrmin në pah pjesën që i shqetësonte, ta njihnin të panjohurën (shfaqjen e mallit dhe kundrimit të fyellit si simbolikë e fuqishme), si dhe në anën tjetër, në kohën e “brezit të ri” të lindnin edhe vargjet lirike të autorit në fjalë. Ja se si del kjo e thënë në vargje e mëposhtme:

O m'thuej, lum baba, sot ç'kujtim t'përloti

Që n'çaste t'liga kurr ma keq s't'kam pa:

Loti yt po m'djeg sa m'ban me qa!

- E ai rroshkue mallit fyellin n'buzë e bjen¹²

Të vërtetën që duhej ta njihnte i biri malësor dhe kureshtja e madhe për botën e jetuar të babait të tij, ndihmojnë që poezia e këtillë ta marrë jo vetëm vlerën e duhur lirike, por të vihet në pah

⁹ Azem Shkreli, (1967), Bulzat, Rilindja, Prishtinë, fq. 27.

¹⁰ Po aty, fq. 29.

¹¹ Azem Shkreli, (1967), Bulzat, Rilindja, Prishtinë, fq. 33.

¹² Po aty, fq. 33.

edhe mënyra e bukur dhe interesante se si në hapësirat e kohës, me të gjitha elementet simbolike dhe përfaqësuese dilte në pah emocioni i bukur i dashurisë njerëzore. Për këtë të fundit duke pasur parasysh vetë funksionimin e normave kanunore në hapësirat malësore shqiptare, autorët guxuan dhe mëtuan që t'i thurnin vargjet më të bukura. Andaj nuk është aspak e rastësishme që vënien në pah të këtij emocioni në këtë poezi bashkëkohore e ndihmon vetë simbolika dhe melodia e fyellit, për të përfunduar si në vargjet e mëposhtme:

*“N’at vetull mali, shif, atje nën pllajë
Fyelli im dikur ndihej n’shtat maje;
Plaka jot-amë pat ikë e çmendë sevdaje
M’hyni n’shpi, e tash kam katër djem”
Dhe fill një vashë n’fierajë
U duk, e djali u skuq...¹³*

Përfundimi

Nga gjithë kjo botë e pasur dhe e veçantë e lirizmit të Azem Shkreli lexuesit nuk njihen vetëm me lirshmërinë e shprehur në krijimin e vargut shqip me synimin e një lirie të vetë “brezit të ri”, por edhe me ruajtjen e elementit të vjetër fshataresk, i cili me simbole të caktuara (siç janë: drapri, shamia, fyelli, bjeshka, ara, djepi, bariu etj) mund të hyjë shumë lehtë në mesin e vargjeve të tilla. Vepra e tij lirike (dhe jo vetëm) duke u nisur nga ideja se shoqërisë së kohës i nevojitej një varg i ri, me një natyrë të re, shumë më ndryshe nga vargu i krijuar më parë e që do ta thyente skemën e vjetër mbi të cilën ndërtohej çdo poezi e mëparshme, arriti që t'i mbizotëronte çdo kohe, si dhe njëkohësisht të tregonte për një vlerë të madhe në morinë e veprave të cilat letërsia shqipe i ngërthen ndër vite në periudhat e saj.

Krijimtaria letrare e këtij autori e ndërtuar mbi simbole dhe elemente të veçanta të marra nga përditshmëria e kohës, siç edhe u pa në vargjet e ilustruara në rrjedhë të punimit, është njëra ndër krijimtaritë e veçanta dhe të zëshme në letërsinë shqipe. Duke e vënë në qendër të vetes një dialog të lehtë mes dy subjekteve të ndryshme lirike në një hapësirë që e lejonte rikujtimin e ngjarjeve nga e kaluara, fjalët të cilat ky autor i periudhës bashkëkohore i vendos nga njëri varg në tjetrin, janë fjalët që në mënyra të ndryshme e rrisin vlerën e shprehjeve letrare në këtë letërsi, që tashmë e krijoi natyrën e vetvetes dhe i ngërtheu pranë saj motivet dhe elementet më të bukura për shprehjen e brendisë njerëzore.

Referencat

- [1] Aristoteli, (2006), Poetika, Çabej, Tiranë;
- [2] Selmani, A., (1996), Poezia dhe individualiteti, Flaka e vëllazërimit, Shkup;
- [3] Shkreli, A., (1967), Bulzat, Rilindja, Prishtinë;
- [4] Vinca, A., (1997), Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe 1945-1980, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, Prishtinë.

¹³ Azem Shkreli, (1967), Bulzat, Rilindja, Prishtinë, fq. 34.